




Pranimi / Dostizanje Prilaz / Dostizanje Received / Delivery	04-04-2022	2	viti god year
Organ / Ustano Organ / Ustano Org / Unit	1847/2022	1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.140/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.140/2022 të datës 18.02.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë Komuna e Prishtinës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, respektivisht kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve të punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. ANULOHET Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 26.01.2022 për ankuesen

II. OBLIGOHET Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses respektivisht Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit Ligjor në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021 në pajtim me legjislacionin në fuqi.

III OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm, që ti ndërmarrë veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën II të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Financave, sipas Akt emërimit të datës 08.12.2011, në pozitën “Zyrtare Ligjore”, në Departamentin Ligjor, me datë 26.01.2022 Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses respektivisht Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit Ligjor në kuadër të Ministrisë së

Financave, Punës dhe Transfereve, ia ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 me të cilin ankuesen e vlerëson me notën e përgjithshme mirë 2.8.

Ankuesja, e pa kënaqur me vlerësimin e rezultatit të punës për vitin 2021 me datë 18.02.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 843/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila e kundërshton vlerësimin e rezultatit të punës për vitin 2021 për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore dhe shkeljeve procedurale dhe me vlerësim të gabuar të gjendjes faktike si dhe e konteston se Udhëheqësi nuk e merr parasysh kompetencën e tij se nuk mund të vlerësoj edhe për periudhën në të cilin ai nuk ka qenë mbikëqyrës i imi, sepse vlerësimi është bërë komplet për vitin 2021, ndërsa Zëvendës Drejtori është caktuar në këtë pozitë nga data 01.04.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 23.02.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datën 04.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 18.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2021; Raporti i punës për muajin prill dhe maj 2021; Raporti i punës për muajin Qershor dhe Korrik 2021; Raporti i punës për muajin Gusht dhe Shtator 2021; Raporti i punës për muajin Tetor 2021; Raporti i punës për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2021 sipas delegimit të punëve të pranuar; Akt emërimi i ankueses; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; E-mail-at e datave 03.03.2022, 09.12.2021, 30.09.2021, 30.08.2021, 06.12.2021, 26.11.2021, 19.10.2021, 12.10.2021, 29.10.2021, 25.10.2021; Procesverbal në bazë të vendimit Nr.15/2021 pika 1.2 mbi pranim dorëzimit e dokumenteve origjinale; Prova shtesë të ankesës të datës 18.03.2022; E-mail-at e datave 02.11.2021, 31.10.2021, 29.10.2021, 24.11.2021, Shkresa e datës 05.11.2021 me numër të protokollit 1899-1/2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankueses të kthehet në rivlerësim, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 është bere me shkelje të dispozitave ligjore dhe shkeljeve procedurale, ankuesja ka pretenduar se vlerësimi i punës për vitin 2021 i është bërë nga personi jo kompetente gjegjësisht mbikëqyrësi aktual m nuk ka mundur të vlerësoj edhe për periudhën në të cilin ai nuk ka qenë mbikëqyrës i saj, sepse Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit Ligjor është caktuar në këtë pozitë nga data 01.04.2021, po ashtu ajo pretendon se vlerësimi i është bërë pa pasur asnjë takim paraprak me mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë, konkretisht pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se është i qëndrueshëm sepse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e nënshkrimit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, i cili përcakton se: ***“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1 takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura;***

1.vlerësimin (notimi) e objektivave”, sepse vlerësimi i është dërguar ankueses në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 i kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: ”Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit”, që në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesja është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit, po ashtu Kolegji nga provat e lëndës ka konstatuar se sipas Vendimit të datës 01.04.2021 me numër 67/2021 të nxjerr nga Zëvendësuesi Sekretari i Përgjithshëm Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit Ligjor në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është caktuar nga data 01.04.2021 dhe rrjedhimisht pretendimi i ankueses se Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit Ligjor që e ka bërë vlerësimin për tërë vitin 2021 është i bazuar pasi që sipas nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë që ka përcaktuar se: “Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues”, rrjedhimisht Udhëheqësi ka qenë i obliguar që në bashkëbisedim me Zëvendës Udhëheqësin paraprak për periudhën janar-prill ti bëhet vlerësimi i rezultati të punës ankueses për vitin 2021 dhe po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësi është takuar me ankuesen gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 43 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankueses për vitin 2021, ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses konkretisht Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit Ligjor me rastin e vlerësimit të ankueses me notën e përgjithshme 2.8 tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesja me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njërës prej objektivave dhe detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj eprori aktual është i obliguar që ankueses ti bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe të ndërmerre të gjitha veprimet me qëllim që vlerësimi i ankueses të bëhet konformë legjislacionit që rregullon çështjen e vlerësimit të nëpunësve civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Udhëheqësi i drejtpërdrejtë të ankuesit respektivisht Zëvendës Drejtori i Departamentit Ligjor në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe në bazë të gjeturave të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021 për ankuesen si dhe të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t’i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji si fakt vendimtar lidhur me shqyrtimin e ankesës, mori parasysh edhe faktin notor se viti 2021 ishte vit i përcjellë me situatën e pandemisë me COVID-19, dhe si rezultat i kësaj të gjitha institucionet publike kanë funksionuar me staf esencial dhe reduktime të stafit, rrethana këto që Kolegji vlerëson se

kanë ndikuar në përmbushjen e objektivave të punës, andaj Kolegji bazuar në këto rrethana konstaton se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses duhet të bëjë rivlerësimin e Rezultateve të punës për vitin 2021, duke marr parasysh të gjitha faktet e cekuar me lartë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.140/2022

Valentina Kaçandolli Bektashi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Trasnfereve;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Trasnfereve dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

